



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIC OF KOSOVO-REPUBLIKA KOSOVA
KUVENDI I KOMUNËS NË SUHAREKË
THE MUNICIPALITY OF ASSEMBLY- SUHAREKA
SKUPSTINA OPSTINE-SUVA REKA



Projekt-RR E G U L L O R E

PËR

MENAXHIMIN E MBETURINAVE NË

TERRITORIN E KOMUNËS SË SUHAREKËS

Suharekë-2023

Në bazë të nenit 12, paragrafi 2, pika (c), nenit 17, pika (f), nenit 40 paragrafi 2, pika (a) dhe (g), të Ligjit Nr. 03/L-040, për vetëqeverisje lokale, “Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr. 28/2008”, nenit 8, pika a, nenit 15 pika f, dhe nenin 19 paragrafi 1, të Ligjit për Financat e Pushtetit Lokal, neneve 15 dhe 34, të Ligjit Nr. 04/L-60, për mbeturina dhe për ndryshimin dhe plotësimin Ligji Nr.08/L-071, “Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr. 28/2011” dhe dispozitat nenit 28, lidhur me nenin 29, të Statutit të Komunës së Suharekës, 01-Nr-8336, të datës 04.11.2008, Kuvendi i Komunës së Suharekës, në mbledhjen e mbajtur më -----, miratoi këtë:

R R E G U L L O R E
P Ë R
MENAXHIMIN E MBETURINAVE NË TERRITORIN E KOMUNËS SË
SUHAREKËS

I. DISPOZITAT E PËRGJITHSHME

Neni 1

Qëllimi:

Kjo rregullore ka për qëllim që të rregulloj çështjen e menaxhimit të mbeturinave komunale, mbeturinat nga ndërtimi dhe rrënimi si dhe mbeturinat nga aktivitetet tjera, të natyrës së ngjashme me ato të amvisërisë, lartësinë e tarifës së taksës për menaxhimin e mbeturinave nga amvisëritë me qëllim që të krijohet një sistem i qëndrueshëm, për administrimin financiar, ruajtjes së natyrës, ambientit jetësor dhe interesat tjera të përgjithshëm.

Neni 2

Fushëveprimi:

Kjo rregullore definon minimizimin e mbeturinave, ndarjen, ruajtjen, shkarkimin, grumbullimin, transportimin, aktivitetet e riciklimit dhe tarifë për mbeturina me qëllim të ruajtjes së mjedisit jetësor të shëndetshëm në juridiksionin e Komunës së Suharekës.

Neni 3

Përkufizimet:

- 3.1 **Mbeturina**- nënkupton substancë, apo objekt që prodhuesi ose zotëruesi e hedh ka për qëllim ta hedhë, apo është i detyruar ta hedhë.
- 3.2 **Menaxhim i mbeturinave**- – nënkupton aktivitetet përfshirë mbledhjen, grumbullimin, transportin, përpunimin-rikuperimin, klasifikimin, deponimin e mbeturinave, mbikëqyrjen e operacioneve të tilla dhe kujdesin, mirëmbajtjen e mëvonshme të vendeve të deponimitit, si dhe veprimet e ndërmarra nga një tregtar ose ndërmjetësues;
- 3.3 **Operator**- nënkupton personin e pajisur me leje përkatëse mjedisore i cili në përputhje me dispozitat e këtij ligji menaxhon, kontrollon, është përgjegjës për objektet dhe pajisjet e mbeturinave dhe është i autorizuar të marrë vendime në lidhje me funksionet ekonomike ose teknike të pajisjeve dhe objekteve.
- 3.4 **Leje përkatëse mjedisore**- nënkupton Leje mjedisore ose Leje mjedisore e integruar ose Leje mjedisore komunale, të përkufizuara sipas ligjit përkatës për mbrojtjen e mjedisit dhe Ligjit përkatës për Parandalimin dhe Kontrollin e Integruar të Ndotjes;
- 3.5 **Person**-nënkupton Personin fizik ose juridik, i cili është i përfshirë në mënyrë të drejtpërdrejtë ose tërthorazi në proceset për menaxhimin e mbeturinave.
- 3.6 **Ripërdorim**-nënkupton çfarë do operimi, me të cilin çdo produkt apo komponentë që nuk është mbeturinë dhe përdoret përsëri për të njëjtin qëllim për të cilin është destinuar
- 3.7 **Mbledhje**-nënkupton mbledhjen dhe transportimin e mbeturinave duke përfshirë klasifikimin paraprak në lloje dhe magazinimin e mbeturinave për qëllime të bartjes deri në objektin për trajtim ose deponim të mbeturinave.
- 3.8 **Mbledhje e ndare**-nënkupton mbledhjen e mbeturinave kur grumbullimi i mbeturinave bëhet në mënyrë të ndarë në lloje, të klasifikuar sipas natyrës dhe pajisjeve për të lehtësuar trajtimin specifik
- 3.9 **Prodhuesi i mbeturinës**-nënkupton secilin person veprimtaria e të cilit krijon /prodhon mbeturinë, ose çdo njëri që merret me paraprocesim përzierje apo operime tjera që rezultojnë në ndryshimin e natyrës apo përbërjen e mbeturinës.
- 3.10 **Zotëruesi i mbeturinës**-nënkupton prodhuesin e mbeturinës apo personin që e zotëron mbeturinën.
- 3.11 **Mbeturina komunale**-nënkupton:
- 3.11.1. mbeturinat e përziera dhe mbeturinat shtëpiake të grumbulluara veç e veç, duke përfshirë letrën dhe kartuçin, qelqin, metalet, plastikën, mbetjet bio, drunjtë, tekstilet, paketimin, pajisjet e mbeturinave elektrike dhe elektronike, bateritë dhe akumulatorët e mbeturinave, mbeturinat vëllimore, përfshirë dyshekët dhe mobiliet;

3.11.2. mbeturinat e përziera dhe mbeturinat e grumbulluara veçmas nga burimet e tjera, kur mbeturinat e tilla janë të ngjashme në natyrë dhe përbërje me mbeturinat shtëpiake.

3.11.3. mbeturinat komunale nuk përfshijnë mbeturinat nga prodhimi, bujqësia, pylltaria, peshkimi, tankerët septike dhe rrjetet e kanalizimeve, si dhe nga trajtimi i ujërave të zeza, duke përfshirë llumrat e ujërave të zeza, mbeturinat e automjeteve ose mbeturinat e ndërtimit.

3.12 **Mbeturina e parrezikshme**-nënkupton mbeturinat që nuk paraqesin rrezik për mjedisin dhe shëndetin e njeriut, dhe që nuk posedojnë karakteristika të mbeturinave të rrezikshme.

3.13 **Mbeturina komerciale**-nënkupton mbeturinat të cilat vijnë nga objektet që përdoren për qëllimet e tregut ose biznesit, sportit, edukimit, rekreacionit, por nuk përfshihen mbeturinat industriale dhe që nënkuptohet çdo mbeturinë e prodhuar nga një biznes duke përfshirë por jo kufizuar, në letër, karton, kënaçe, paketim me pakicë dhe mbështjellës ushqimi.

3.14 **Mbeturina inerte**-nënkupton mbeturinat që nuk kanë ndonjë ndryshim të rëndësishëm fizik, kimik apo biologjik në vendet ku janë deponuar si:

3.14.1 mbeturinat inerte që nuk treten, nuk ndizen ose nuk reagojnë fizikisht apo kimikisht, nuk zbërthehen biologjikisht në kontakt me materiet e tjera dhe nuk ndikojnë në mënyrë të ndjeshme në mjedisin dhe shëndetin e njeriut.

3.14.2 i tërë kullimi dhe përmbajtja ndotëse e mbeturinës, mbetjet ekotoksike duhet të jenë të vlerës së papërfillshme dhe të mos rrezikojnë cilësinë e ujërave sipërfaqësore dhe nëntokësore

3.15 **Mbeturinë e vëllimshme**-nënkupton mbeturinat me përmasa të mëdha fizike nga pajisjet dhe makineritë, grumbullimi, transportin dhe largim të cilave bëhet në mënyrë të veçantë.

3.16 **Mbeturinat ndërtimit dhe rrënimi**- nënkupton mbeturinat e krijuara nga aktivitetet e ndërtimit dhe prishjes;

3.17 **Mbeturina ushqimore** - nënkupton mbeturinat e çdo substance apo produkti, qofte i përpunuar, i përpunuar pjesërisht ose i papërpunuar, e që pritet të konsumohet nga njerëzit, pijet, çamçakëzët dhe çdo substance, përfshirë edhe ujin, të përfshirë qëllimisht në ushqim gjatë prodhimit, përgatitjes ose trajtimit të tij.

3.18 **Qendra grumbulluese**-nënkupton lokacionin për grumbullimin e mbeturinave të ndara sipas llojeve të përcaktuara.

3.19 **Deponi** – vend i caktuar dhe rregulluar për mbeturina, ku do të vendosen mbeturinat nën apo mbi sipërfaqe të tokës.

3.20 **Konsumator**- personi i cili ka lidhur kontratë për shërbime me ofruesin e shërbimeve ose merr shërbime të caktuara sipas ligjit.

Neni 4

Llojit e mbeturinave;

4.1 Llojet e mbeturinave të cilat i menaxhon Komuna në bazë të kësaj rregulloreje janë si në vijim:

4.1.1 Mbeturina komunale janë mbeturina nga amvisëritë, dhe mbeturina nga aktivitetet tjera të cilat për shkak të përbërjes dhe natyrës së tyre, janë të ngjashme me ato të amvisërisë.

4.1.2 Mbeturina inerte që nuk treten, nuk ndizen ose nuk reagojnë fizikisht apo kimikisht, nuk zbërthehen biologjikisht në kontakt me materiet tjera dhe nuk ndikojnë në mënyrë të ndjeshme në mjedisin dhe shëndetin e njeriut;

4.1.3 Mbeturina të vëllimshme - mbeturina me përmasa të mëdha fizike nga pajisjet e amvisërisë dhe mobilet.

4.1.4 Mbeturina nga ndërtimi dhe rrënimi mbeturina të gjeneruara nga aktivitetet ndërtimore;

4.1.5 Bio-mbeturinë janë mbeturinat biodegraduese nga kopshtet, parqet, ushqimet dhe mbeturinat e kuzhinës nga familjet, restorantet, objektet turistike, shitoret me pakicë dhe mbeturinat të ngjashme nga impiantet për përpunimin e ushqimit;

4.2 Mbeturina komerciale janë mbeturinat të cilat vijnë nga objektet që përdoren për qëllimet e tregut ose biznesit, sportit, edukimit, rekreacionit, por nuk përfshihen mbeturinat industriale.

4.3 Mbeturina industriale janë mbeturinat të cilat krijohen nga aktivitetet, proceset industriale, prodhimi artizanale dhe veprimtari tjera prodhuese;

4.4 Mbeturina medicinale janë mbeturina patologjike të cilat krijohen nga aktiviteti medicinal, si dhe materialet e tjera që përdoren në shërbimet mjekësore;

4.5 Mbeturinat shtazore-janë mbeturina që krijohen nga amvisëritë, thertoret, mishtoret dhe aktivitetet e tjera të ngjashme.

Neni 5

Përjashtimet;

5.1 Nga kjo rregullore përjashtohen mbeturinat në vijim:

5.1.1 mbeturinat e rrezikshme dhe

5.1.2 llumi/ balta dhe mbeturina të ngjashme

5.2 Menaxhimi i tyre rregullohet në bazë të akteve nënligjore të miratuar nga organi kompetent.

Neni 6

Përgjegjësia e Komunës për Menaxhimin e Mbeturinave:

- 6.1. Krijimi i një sistemi të qëndrueshëm mbi menaxhimin e mbeturinave të ngurta komunale.
- 6.2. Krijimi i një sistemi të qëndrueshëm financiar.
- 6.3. Krijimi i procesit të kontraktimit për shërbimet e grumbullimit të mbeturinave.
- 6.4. Autorizimi i operatorit që të beje mbledhjen e mbeturinave e dhe jashtë orarit dhe dinamikës së paraparë, sipas nevojës
- 6.5 Të themelon në kuadër të Departamentit të Shërbimeve Publike të Suharekës, Sektorin e menaxhimit të mbeturinave, i cili monitoron dhe ofron udhëzime për ofruesit e shërbimeve për grumbullimin, transportimin dhe deponimin e mbeturinave, menaxhon me bazën e të dhënave të gjeneruesve të mbeturinave shtëpiake dhe vepron sipas planit komunal për menaxhimin e mbeturinave.
- 6.6 Të bëjë monitorimin mjedisor të deponisë së mbeturinave.
- 6.7 Të identifikoj pikat ilegale (të zeza) të hedhjes së mbeturinave dhe evitimi i tyre.
- 6.8 Promovimi për minimizimin e mbeturinave (3R, kompostimit shtëpiak etj.)
- 6.9 Promovimi i ngritjes së vetëdijesimit publik- pjesëmarrja aktive e qytetarëve në implementimin e menaxhimit të mbeturinave të ngurta.
- 6.10 Planifikimin buxhetor mbi funksionimin e menaxhimit të mbeturinave.
- 6.11 Faturimi i tarifës mbi mbeturinat, organizimi dhe shpërndarja.
- 6.12 Përpilimi i raporteve, mbi menaxhimin e mbeturinave, dhe shkallën e inkasimit të tarifës mbi mbeturinat.
- 6.13 Formimi i komisionit në kuadër të administratës komunale, për shqyrtimin e ankesave dhe parashtresave të taksapaguesve për mbeturina.
- 6.14 Propozon përcaktimin e tarifës dhe mënyrën e arkëtimit të mjeteve financiare për menaxhimin e mbeturinave, për miratim në Kuvendin e Komunës.
- 6.15 Dorëzimi i Raportit në Ministrin e Mjedisit dhe planifikimit Hapësinor, për MMN çdo 31 mars të vitit pasues.
- 6.16 Komuna ka përgjegjësi që të sigurojë kushte veprimi dhe operimi për operatorët publik dhe privat.
- 6.17 Trajtimi i mbeturinave nga ndërtimi dhe rrënimi, si dhe i mbeturinave inerte, komerciale, të vëllimshme brenda territorit të komunës
- 6.18 Hartimi i planit komunal për menaxhimin e mbeturinave (PKMM);

6.19 Të krijoj bazën e të dhënave me shënime për amvisëritë, bizneset dhe institucionet publike dhe private që pranojnë shërbime komunale të grumbullimit të mbeturinave, të cilat shënime (apo regjistra) përmbajnë të dhënat për përdoruesit e shërbimeve, të dhënat personale, adresën si dhe të dhënat e tjera të nevojshme. Këto të dhëna duhet të përditësohen rregullisht nga ana e komunës, përkatësisht nga Sektori mbi menaxhimin e mbeturinave -Drejtoria e Shërbimeve Publike.

6.20 Grumbullimin e mbeturinave të vëllimshëm komuna do ta bëj së paku dy herë në vit, pa pagesë, sipas planit komunal për menaxhimin e mbeturinave ,

Neni 7

Sistemi i menaxhimit të mbeturinave komunale

7.1. Mbeturinat komunale duhet të mblidhen, transportohen, grumbullohen, trajtohen dhe menaxhohen në përputhje me dispozitat e Ligjit për Mbeturina dhe me këtë Rregullore.

7.2. Komuna ofron sistemin e shërbimit të menaxhimit të mbeturinave përmes operatorëve të licencuar pubilk, privat apo publiko-privat.

7.3. Mbeturinat grumbullohen nga amvisëritë, institucionet, bizneset, hotelet, restaurantet dhe hapësirat publike, grumbullimi i këtyre mbeturinave do të ofrohet në shërbimin:

7.3.1. sistemin i grumbullimit derë më derë dhe

7.3.2 në pikat grumbulluese me kontejner-hapësira publike.

7.4. Komuna përmes Sektorit të menaxhimit për mbeturina përkatës, bën përzgjedhjen dhe caktimin e vendeve, pikave grumbulluese të mbeturinave, caktimin e hapësirave për ndërtim të qendrave të mëdha për grumbullim. Pikat grumbulluese caktohen sipas Planit Komunal për menaxhimin e mbeturinave.

7.5. Menaxhimi i mirë i mbeturinave nënkupton: mbulueshmëri me shërbim në tërë hapësirën komunale, shërbim të rregullt dhe cilësor. Standartet cilësore të menaxhimit të mbeturinave përcaktohen në Planin komunal për menaxhimin e mbeturinave (PKMM).

7.6. Ngritja e vetëdijesimit publik që ka për objektive ngritjen e vetëdijes shoqërore për menaxhimin e mbeturinave, puna me komunitet, palët e interesit, të gjitha institucionet edukativo-arsimore të cilat funksionojnë në territorin e komunës, duhet të edukojnë të gjithë qytetarët në përputhje me rregullat dhe ligjet përkatëse të trajtimit të mbeturinave.

Neni 8

Kategorizimi i gjeneruesve të mbeturinave;

Gjeneruesit e mbeturinave kategorizohen si më poshtë:

8.1 Konsumatorët e amvisërive:

8.1.1 të shërbyer përmes kontejnerëve të përbashkët dhe

8.1.2 të shërbyer sipas shërbimit derë më derë

8.2 Konsumatorët komercialë/industrialë:

8.2.1 dyqanet e vogla zejtare dhe shërbyese

8.2.2 subjekte të mesme deri të mëdha komerciale me kosto të ulëta të shërbimit

8.2.3 subjekte të mesme deri të mëdha komerciale me kosto të lartë të shërbimit

8.3 Konsumatorët Institucional:

8.3.1 konsumatorët e vegjël institucionalë

8.3.2 konsumatorë e mesëm dhe të mëdhenj institucionalë

8.3.2 konsumatorët e mëdhenj institucionalë, të shërbyer me kontratë

8.4 Detajizimi i mëtejshëm i këtyre kategorive gjendet në shtojcën A të kësaj rregulloreje.

Neni 9

Të drejtat dhe detyrat e gjeneruesve të mbeturinave;

9.1. Çdo gjenerues i mbeturinave ka të drejtë qasjeje në shërbimin e grumbullimit të mbeturinave,

9.2. Të gjithë gjeneruesit e mbeturinave janë të obliguar të regjistrohen në bazën e të dhënave në Sektorin e menaxhimit të mbeturinave-Drejtoria e Shërbimeve Publike dhe të lidhin kontratën për shërbimin të gjeneruesit për mbledhjen dhe bartjen e mbeturinave.

9.3. Gjeneruesit e mbeturinave janë të obliguar që të paraqesin ndryshimet e të dhënave përmes kërkesës zyrtare (si p.sh adresën, shitjen e pronës, trashëgimia, dëshmi dhe dokumente të përditësuara etj), në bazën e të dhënave tek Sektori i menaxhimit të mbeturinave-Drejtoria e Shërbimeve Publike.

9.4. Çdo gjenerues i mbeturinave ka të drejtë ankese, ndaj shërbimit të ofruar.

9.5. Çdo gjenerues i mbeturinave të ngurta duhet të respektoj rregullat e shkarkimit të përcaktuar sipas planit komunal të menaxhimit të mbeturinave.

9.6. Çdo gjenerues duhet të bëjë përpjekje për minimizimin e mbeturinave (përmes 3R, kompostimit shtëpiak dhe formave tjera të mundshme)

9.7. Për shërbimin e ofruar, gjeneruesi obligohet të paguaj tarifën e shërbimit.

9.8. Çdo gjenerues, duhet të bashkëpunoj me autoritetin publik, për të siguruar një mjedis të pastër dhe të shëndetshëm.

9.9. Ndërmarrjet prodhuese, të cilat gjenerojnë mbeturina, obligohen që komunës së Suharekës t'ia dorëzojnë planin e menaxhimit të mbeturinave, të cilat i gjenerojnë gjatë ushtrimit të veprimtarisë.

9.10. Gjeneruesit e mbeturinave obligohen që mbeturinat e tyre ti hedhin në vende të caktuara nga ana e Komunës për mbledhjen e mbeturinave ndërsa mbeturinat e rrezikshme, ti ndajnë dhe ti dorëzojnë në pikatë mbledhëse apo në vendet e caktuar nga Komuna

Neni 10

Baza e të dhënave dhe regjistrimi i gjeneruesve të mbeturinave komunale

10.1 Komuna e Suharekës-Drejtoria e Shërbimeve Publike-Spektori i menaxhimit të mbeturinave do të krijoj bazën e të dhënave për të gjithë gjeneruesit e mbeturinave komunale në territorin e kësaj komune, konform Ligji Nr.06/L-082- Ligji për mbrojtjen e të dhënave personale sipas nenit 5 paragrafi 1.5.

10.2 Baza e të dhënave do të regjistroj të dhënat personale të gjeneruesve, përcaktimin e llojit të mbeturinave nga gjeneruesit, kategorizimin e gjeneruesve, shumë e faturimit të tarifës dhe shumë e inkasimit të tarifës për grumbullimin e mbeturinave, me qëllim të interesit publik për implementimin e planit për menaxhimin efikas të mbeturinave komunale.

10.3 Përgjegjësi e menaxhimit, përditësimit dhe mirëmbajtjes së bazës së të dhënave i takon Komunës së Suharekës-Drejtoria e Shërbimeve Publike-Spektori i menaxhimit të mbeturinave.

10.4 Regjistrimi i gjeneruesve të mbeturinave komunale, bëhet me paraqitjen e këtyre dokumenteve:

- a) dokumentin identifikues (letërnjoftimi, pasaporta)
- b) dokumentet e regjistrimit për personat juridik (çertifikata e biznesit ose akt themelimi etj)
- c) dëshmi- njehsorin e rrymës elektrike;
- d) dëshmi mbi regjistrimin e objektit në tatimin në pronë;
- e) dëshmi e pagesës së faturës për mbeturina në adresën ku ka banuar më parë (në rastet kur gjeneruesi e ndërron adresën e banimit)
- f) dëshmi të çertifikatës familjare (për kategorizim të faturës së tarifës në individë/familje)
- g) në rastet e shitblerjes së objekteve, shitësi dhe blerësi duhet të kenë të paguar borxhin paraprak për mbeturinat në tërësi dhe të paraqesin kontratën e shitblerjes, për të i bërë ndryshimet në data bazë dhe në faturim.

10.5. Gjeneruesit të cilët posedojnë dy apo më shumë fatura të tarifës për mbeturina, për objekte banimi aktive, duhet të lajmërohen para organit komunal, respektivisht SMM për kategorizimin e ngarkesës së faturës.

10.6 Në rastet e dyfishimit të faturave për të njëjtin gjenerues, anulohet/fshihen faturat nga baza e të dhënave për menaxhimin e mbeturinave nëse ofrojnë dëshmi të mjaftueshme.

Neni 11

Mbeturinat Komunale nga ndërtimit dhe rrënimi i objekteve ndërtimore

11.1 Gjatë procesit të ndërtimit, meremetimit apo rrënitimit të objekteve, personat fizik dhe juridik duhet ti largojnë nga hapësirat ose vendet publike mbeturinat të cilat i krijojnë.

11.2 Mbeturinat nga ndërtimi dhe rrënimi duhet të hidhen në deponin legale e cila përcaktohet me vendim ligjor nga Kuvendi Komunal i Suharekës.

11.3 Transportimi i këtyre mbeturinave, bëhet nga vetë prodhuesit ose ndërmarrjet për në pikat e mbledhjes së mbeturinave ose në vend deponit e caktuara nga organi komunal.

11.4 Të gjithë personat fizik dhe juridik të cilëve ju lëshohet leje për shembjen ose ndërtimin e objekteve, duhet të veprojë sipas Ligjit për mbeturina Nr.04/L-060, të plotësohet formulari shtojca V për bartjen e mbeturinave të ndërtimit dhe rrënitimit, nga prodhuesi, transportuesi dhe pranuesi i mbeturinave.

11.5 Secili prodhues i mbeturinave të ndërtimit dhe rrënitimit obligohet të veprojë në përkujdesje mjedisore, duke vepruar sipas Ligjit Nr. 04/L-60 për mbeturina, Ligji Nr.08/L-071 për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit Nr.04/L-060 për mbeturina, Udhëzimi Administrativ të MMPH Nr.07/2015 për menaxhimin e mbeturinave të ndërtimit dhe rrënitimit të objekteve ndërtimore dhe Rregullores për menaxhimin e mbeturinave në Komunën e Suharekës.

11.6 Të gjithë operatorët publik dhe privat në transportimin e mbeturinave, trajtimin dhe përpunimin, si dhe operatorët në deponi të mbeturinave të ndërtimit dhe rrënitimit duhet të jenë të pajisur me leje përkatëse sipas Ligji Nr.08/L-071 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për Mbeturina Nr.04/L-060 dhe akteve nënligjor të Ministrisë.

11.7 Dorëzuesit e mbeturinave të ndërtimit dhe rrënitimit në deponin legale për këto mbeturina, duhen të paguaj tarifën e përcaktuar nga Komuna e Suharekës. Kjo pagesë bëhet në deponin tek zyrtarët menaxhues të deponisë.

Neni 12

Përcaktimi i tarifës për grumbullimin e mbeturinave komunale dhe për deponimin e mbeturinave të ndërtimit dhe rrënitimit

12.1. Tarifa mbi mbeturinat komunale faturohet dhe inkasohet nga Komuna e Suharekës. faturimi i tarifës së mbeturinave bëhet në bazë vjetore kurse fatura i dorëzohet gjeneruesit të mbeturinave, më së largu deri me datën 10 të muajit pasues.

12.2. Në përcaktimin e tarifës për grumbullimin dhe transportimin e mbeturinave të amvisërisë duhet të merren parasysh këto elemente ndikuese:

12.2.1 Shpenzimet operative te grumbullimit të mbeturinave (transporti, mirëmbajtja e mjeteve transportuese, burimet njerëzore etj)

12.2.2 Tarifa e pranimit nga deponia e mbeturinave.

12.2.3 Elementet tjera të ndikueshme nga aspekti ekonomik dhe ndikuesit tjerë për menaxhimin sa me efikas të mbeturinave.

12.3. Gjeneruesi i mbeturinave obligohet që të paguajë faturën e tarifës së mbeturinave për çdo muaj të vitit si dhe në këste, nga 3 mujore brenda vitit, si më poshtë:

12.3.1 Kësti parë Janar - Mars

12.3.2 Kësti i dyte Prill - Qershor

12.3.3 Kësti i tretë Korrik- Shtator

12.3.4 Kësti i katërt Tetor-Dhjetor

12.4. Pagesa e tarifës për mbeturina bëhet në institucionet financiare për pagesa, në llogarinë bankare përkatëse të Komunës së Suharekës.

12.5 Të gjithë familjar që janë me asistencë sociale lirohen nga pagesa e mbeturinave.

12.6 Në përcaktimin e tarifës për pranimin e mbeturinave të ndërtimit dhe rrënimit nga objektet ndërtimore, duhet të merren parasysh këto elemente ndikuese:

12.6.1. Shpenzimet dhe mirëmbajtja e ekskavatorit, mirëmbajtja e automjeteve tjera

12.6.2. Mbulesa me zhavorr, zbrazja e lagunës dhe largimi i borës

12.6.3. Shpenzimet mirëmbajtjes së zyrës së deponisë (ndriçimi, uji, ngrohja) dhe ato administrative

12.6.4. Shpenzimet e pagave mujore të punëtorëve të deponisë.

12.6.5. Elemente tjera të nevojshëm për menaxhimin e duhur të mbeturinave të ndërtimit dhe rrënimit.

12.7 Kalkulimi dhe përcaktimi i shumës në valutën € (euro) për tarifën e mbeturinave të ndërtimit dhe rrënimit, përcaktohet me vendim të veçantë nga Kuvendi Komunal i Suharekës, sipas elementeve ndikuese nga neni 12 paragrafi 12.6 të kësaj rregullore.

Neni 13

Tarifa mbi mbeturinat komunale të amvisërisë

13.1 Fatura e tarifës komunale për mbeturinat komunale i lëshohet çdo kryefamiljari, individi dhe personave juridik

13.2 Tarifa komunale e mbeturinave shtëpiake ndahet në tre kategori, në:

13.2.1 tarifa e mbeturinave shtëpiake për banorët rezidentë/komunal/individë: XX, muaj

13.2.2 tarifa e mbeturinave shtëpiake për banorët rezidentë/komunal/familje: XX muaj

13.2.3 tarifa e mbeturinave shtëpiake për banorët jorezident/diaspora/familje & individë: X /familje & individë /muaj, llogaritja e takes bëhet si më poshtë:

Tv= tarifa vjetore

M= numri i muajve të vitit me mbi 15 € shpenzime elektrike (maksimum 6 muaj),

T= tarifa mujore (€),

12=muajt ne vitin kalendarik,

t = tarifa mujore me më pak se 15 € shpenzime elektrike (€) =1€'

Shembull: M =3, Tv =6.00, t =1€, atëherë $Tv = 3 \times 6.00€ + (12-3) \times 1€ = 18 + 9 = 27.00 €$

a) Nëse çmimi i energjisë elektrike do të ndryshojë, do të ndryshoj edhe shuma maksimale (15€) sipas përqindjes së ndryshimit.

13.3 Tarifa për mbeturinat komunale për konsumatorët komercial, industrial dhe institucionale kategorizohet dhe përcaktohet ne shtojcën A të kësaj rregullore.

13.4 Banorët rezidentë janë individë apo familje të cilët jetojnë në vazhdimësi më shumë se 9 muaj në vit, në territorin e komunës ndërsa banorët jo rezidentë/diaspora janë individë apo familje që banimi i tyre zgjatë 3 ose më pak muaj në territorin e komunës.

13.5 Individët dhe kryefamiljarët të cilët dëshirojnë të faturohen në kategorinë e taksës komunale të mbeturinave shtëpiake si jorezident/diaspora duhet të paraqesin dëshmi se ata qëndrojnë jashtë shtetit për 9 ose më shumë muaj. Ky vërtetim bëhet përmes paraqitjes për inspektim nga zyrtari komunal në Qendrën e Shërbimit të Qytetarëve, paraqitjen e pasqyrës së transaksioneve vjetore të energjisë elektrike nga viti i kaluar, ku secila tregon një sasi mujore të konsumit energjisë elektrike të barabartë ose nën XX kwh për muaj.

Neni 14

Obligimi i pagesës së tarifës për mbeturinat

14.1 Të gjithë gjeneruesit të cilët marrin shërbim mbi grumbullimin e mbeturinave dhe janë te regjistruar në bazën e të dhënave, detyrohen të paguaj tarifën. Nëse gjeneruesi i mbeturinave nuk i paguan 2 këste të njëpasnjëshme (janar-mars dhe prill-qershor), ndaj secilit gjenerues do të iniciohet procedure e përmbarimit tek përparuesit privat për pagese të detyrueshme të borxhit.

14.2. Shkalla e tarifës do të rishikohet çdo dy vjet nga Drejtoria e Shërbimeve Publike, Mjedis dhe Emergjencë-Sektori i menaxhimit të mbeturinave, duke marr parasysh performancën e shkallës së inkasimit, etj.

14.3 Kur Kuvendi Komunal në Suharekë miraton shkallën e përshtatshme të propozuar për vitin në vijim, njoftohen qytetarët para vitit të ardhshëm fiskal.

14.4 Tarifa minimale e shërbimit të grumbullimit të mbeturinave tu ofrohet institucioneve dhe bizneseve të mëdha, të kontraktohen individualisht siç edhe është përcaktuar për të ruajtur kualitetin e shërbimit të grumbullimit të mbeturinave.

Neni 15

Detyrat dhe Përgjegjësit e Operatorëve të kontraktuar për Shërbimin e Mbeturinave;

15.1 Operatori i kontraktuar nga organi kontraktues, për ofrimin e shërbimeve për menaxhimin e mbeturinave duhet të jetë i pajisur me leje dhe është i obliguar që të veproj sipas kontratës, ligjeve në fuqi dhe kësaj rregulloreje.

15.2 Operatori i kontraktuar për menaxhimin e deponisë legale për mbeturinat e ndërtimit dhe rrënimin obligohet të dorëzoj “Planë të Menaxhimit të Mbeturinave” për periudhë 5 vjeçare në komunën e Suharekës, se si do të trajtoj, menaxhoj dhe ricikloj këto mbeturina në deponin e cila ju ka ofruar për menaxhim, duke e mirëmbajtur dhe menaxhuar sipas kushteve të cilat janë parapa nga kontrata përkatëse e lidhur në mes të komunës së Suharekës dhe operatorit.

15.3 Operatori menaxhues i deponisë legale për mbeturinat e ndërtimit dhe rrënimin obligohet të dorëzoj raporte mujore, të cilat prezantojnë sasinë e mbeturinave të dorëzuara në deponi, sasinë e ricikluar të mbeturinave të ndërtimit dhe rrënimin, identifikimin e prodhuesve të këtyre mbeturinave dhe shumën e pagesës së tarifës nga gjeneruesit e mbeturinave. Raportet mujore dorëzohen më së largu në ditë e tretë të çdo muaji vijues, në Drejtorin e Shërbimeve Publike, Emergjencë dhe Mjedis-Sektori për menaxhimin e mbeturinave.

Neni 16

Veprimet e ndaluara

16.1 Në bazë të kësaj rregulloreje ndalohen veprimet si më poshtë;

16.1.1 Hedhja e mbeturinave ndërtimore në rrugë, trotuare, sheshe apo mjedise publike;

16.1.2 Hedhja e mbeturinave të llojeve të tjera në kontejnerë ose në pikat mbledhëse të mbeturinave, të cilat nuk ndahen ashtu siç është parapare;

16.1.3 Hedhja e mbeturinave në hapësirat përbashkëta, brenda dhe jashtë objekteve të banimit kolektiv (ballkone, korridore, tarraca të banesave eti);

16.1.4 Përzierja dhe hedhja e mbeturinave jashtë kontejnerëve të destinuar për ndarjen e mbeturinave të ricikluara;

16.1.5 Hedhja e mbeturinave në rrugë nga automjetet në lëvizje;

16.1.6 Hedhja dhe deponimi i mbeturinave në hapësirat publike (në rrugë, parqe dhe në vende të tjera publike);

- 16.1.7 Ndërrimi i vendndodhjes së kontejnerëve, pikave ose vendeve të betonuara për hedhjen e mbeturinave pa autorizim të autoriteteve komunale;
- 16.1.8 Djegia e mbeturinave në vende publike, kontejnerë, apo në pikat mbledhëse ose ndarëse të mbeturinave;
- 16.1.9 Shfrytëzimi i mbeturinave si ushqim për kafshë apo të ngjashme, nga kontejnerët ose pikat mbledhëse të mbeturinave;
- 16.1.10 Shfrytëzimi i kontejnerëve publik nga bizneset, veprimtaritë ekonomike për llojet e mbeturinave që nuk përfshihen në përkufizimin "mbeturina komunale dhe komerciale";
- 16.1.11 Gërmimi, përzieja, derdhja dhe përhapja e mbeturinave të hedhura në kontejnerë, ose në pikat mbledhëse nga personat e pa autorizuar.
- 16.1.12 Hedhja e mbeturinave jashtë kontejnerëve të mbeturinave;
- 16.1.13 Derrdhja apo rrjedhja e mbeturinave prej automjeteve gjatë transportimit për në impiantet për trajtim apo për deponim në deponi të mbeturinave;
- 16.1.14 Personat e autorizuar për transportin e mbeturinave duhet të marrin masa që gjatë transportimit të mbeturinave, automjetet e tyre të kenë mbulesë adekuate me qëllim të pengimit të derdhjes, shpërndarjes apo rrjedhjes së mbeturinave gjatë transportit me destinacion tek impiantet për trajtim apo në deponin të mbeturinave;
- 16.1.15 Mbeturinat nga pajisjet elektrike, elektronike dhe të vëllimshme nuk guxojnë të hedhen në kontejnerë të mbeturinave ose në afërsi të tyre.

Neni 17

Dispozitat Ndëshkuese - Gjobat;

- 17.1 Ndaj gjeneruesit të mbeturinave, i cili nuk e bën pagesën e taksës për mbeturina do të iniciohet procedurë gjyqësore në gjykatën kompetente ose me procedura përmes përmbauesve privatë.
- 17.2 Për shkelësit e dispozitave të kësaj rregulloreje, inspektori komunal shqipton gjobë mandatorë sipas, Ligji Nr.08/L-071 për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit Nr.04/L-060 për mbeturina.

DISPOZITAT KALIMTARE DHE TË FUNDIT

Neni 18

- 18.1 Për zbatimin e kësaj rregulloreje janë kompetente Drejtoria Inspektoratit dhe Drejtoria për shërbime publike, emergjencë dhe mjedisit i organit komunal përkatës, si dhe Policia e Kosovës.
- 18.2 Në të gjitha rastet që nuk janë të rregulluara me këtë rregullore, do të zbatohen dispozitat e Ligjeve në fuqi dhe akteve nënligjore të aplikueshme në Republikën e Kosovës

Neni 19

Kjo rregullore mundë të ndryshohet dhe plotësohet në procedurë të njëjtë me atë të miratimit nga Kuvendi i Komunës në Suharekë, me propozimet e arsyetuare nga propozuesi.

Neni 20

Pas miratimit nga Kuvendi i Komunës në Suharekë, kjo rregullore hynë ne fuqi 15, ditë pas dërgimit në autoritetin mbikëqyrës, në kuptim të nenit 81, të Ligjit Nr-03/L-040, për Vetëqeverisjen Lokale, “Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr-28/2008” dhe nenit 8, të Rregullores, Nr-01/2016, për procedurat e hartimit dhe publikimin e akteve të Komunave dhe pas shpalljes publike në tabelën e shpalljeve ose web-faqen e Komunës.

Shfuqizohet Rregullore për menaxhimin e mbeturinave në territorin e komunës së Suharekës ,
01-Nr-110-18191 e datës 21.05.2020

KUVENDI I KOMUNËS NË SUHAREKË

01-Nr- _____

Me data _____

Kryesuesi i Kuvendit

SHTOJCA A: Tarifa e taksës për mbeturina;

Ç M I M O R E

LISTA E KONSUMATOREVE PËR SHËRBIMET E GRUMBULLIMIT TË MBETURINAVE (MUJORE) PËR VITIN 2023

I. Kategoria amvisëri : Shërbimi derë-më derë dhe me kontenier të përbashkët

Tarifat mujore	Tarifa 6.00 euro / njësi familjare 4.50 euro / individë
Kategoritë	Amvisëri rezident / jo rezident (diaspora)

II. KATEGORIA E KONSUMATOREVE KOMERCIAL / INDUSTRIAL : Shërbimi derë-më derë dhe me kontenier të përbashkët

Zona e Parë	Zona e dytë	Zona e tretë
Suharekë	Sopijë	Stravuqin
Shirokë	Savrovë	Krushicë e ulët
Reshtan	Bukosh	Budakovë
	Vraniq	Krushicë e epërme
	Reqan	Mohlan
	Mushtisht	Doberdelan
	Dubravë	Nishor
	Sallagrazhd	Kasterc
	Grejkoc	Delloc
	Gjinoc	Maqitevë
	Gelancë	Papaz
	Leshan	Vërshec
	Tërrnje	Qadrak
	Nepërbisht	Grejqevc
	Samadrexhë	Luzhnicë
	Studenqan	Breshanc
	Semetisht	

	Peqan	
	Bukosh	
	Bllacë	
	Duhël	
	Sllapuzhan	
	Dvoran	
	Populan	

Vërejtje: kontinieri 1.1 m³ x 61.50 euro për një zbrazje është për mishtore dhe xhampresa.

III. Kategoria e konsumatorëve Institucional.

Tarifa mujore 6.70 euro	Tarifa mujore 13.65 euro	Tarifa mujore 22.96 euro	Tarifat mujore 1 kontenier 1.1 m ³ (46.50 euro)
Zyre e partive Politike, Përfaqësitë të shoqatave, Objekte fetare	Teatër Galeri e arteve Biblioteka Çerdhe	Bankat Mikro financat Institucionet Financiar Zyre postare Keds Kost Hidroregjioni Të ngjashme	Objektet Komunale Ambulancat Shkollat Gjykatat Posta Policia Qendra regjistrimit (qkrc) Stacioni autobusëve Salla sportive
Shërbimet e ofruara me kontenjerë të veçantë			
Vëllimi I kontejnerit	1.1 m ³	5.0 m ³	7.0 m ³
Tarifa (euro/zbrazje)	12.80 euro	Nuk ka te tilla	48.50 euro

Të gjitha tarifat e përcaktuara janë me Tatimin mbi vlerën e shtuar (TVSH 8%).

I. Tarifa mujore	II. Tarifa mujore	III. Tarifa mujore	IV. Tarifa mujore	V. Tarifa mujore
Zona A: 6.70 euro Zona B: 6.00 euro Zona C: 5.00 euro	Zona A: 8.50 euro Zona B: 7.00 euro Zona C: 5.50 euro	Zona A: 10.50 euro Zona B: 7.50 euro Zona C: 6.70 euro	Zona A: 13.65euro Zona B: 11.50euro Zona C: 7.50euro	Zona A: 22.96euro Zona B: 16.50euro Zona C: 11.50euro
Avokaturat Zyre tjera Agjencionet Bizhuteritë Argjendarit Optika Çajtores Kozmetikët Këpucëtarët Ortarët Farkëtaret Kafe pjekësit Video lojërat Kurset e gjuhëve Kiosqet Fotografisë Auto parkingjet Auto larjet Rrobaqepëse Këmbimoret	Kompanitë sigurimeve Auto shkollat Frizerët Mobil shop Kompjuter shop Auto elektrikist Auto mekanik Auto veglat Barnatore bujqesore Auto pjesë Librarit Elektro material Vullkanizer Bastoret Hekurishtet Zdrukthëtaret Servis teknikes bardh Parkingjet	Butikët Barnatoret Dyqanet e këpucëve Sanitarit Laboratorët Mini market Dyqanet Tekstil Sallonet e perdeve Sallone teknike bardh Pllacet ndërtimore	Kafiterit Ëmbëltoret Qebaptoret Byrektoret Gjellëtoret Piceritë Marketet Motelet Pompë benzinës (vetëm pompë) Sallonet e tepihëve Mobilierit Kazinotë Ordinancat Depot e pijeve Depot ushqimore	Restorantet Hotelet Furrat Pompa Benzinës – me objekt përcjellës
Çmimet sipas zbrazjeve				
Vëllimi I Kontinerit	1.1 m ³	5.0 m ³	7.0 m ³	
Tarifa (Euro/zbrazje)	12.80 euro	Nuk ka të tillë	48.50 euro	